



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS
KOMISIONI I ANKIMIT

Nr. 434/14 prot.

Tiranë, më 17.03.2025

VENDIM

“Për shqyrtimin e ankimit të organizatës jofitimprurëse “Shoqata Mbrojtja e të Drejtave të gruas qytetare dhe fshatare (MDG) Berat” ndaj Vendimit të Komisionit të Vlerësimit Nr. 6, datë 20.02.2025, për refuzimin e aplikimit për kërkesën për përfitim financimi nga buxheti i shtetit për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti”

Komisioni i Ankimit i përbërë prej:

Z. Erjon Ndreca - Kryetar
Zj. Klejda Poçi - Anëtar
Zj. Arsilda Mamica - Anëtar

asistuar nga Sekretariati Teknik, sot, më datë 17.03.2025, mori në shqyrtim ankimin administrativ, për refuzimin e aplikimit për përfitimin e financimeve nga buxheti i shtetit për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, të organizatës **“Shoqata Mbrojtja e të Drejtave të gruas qytetare dhe fshatare (MDG) Berat”**, depozituar pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas me datë 03.03.2025, protokolluar me nr. 434/3 Prot, me të dhënat e mëposhtme:

ANKUES: **“Shoqata Mbrojtja e të Drejtave të gruas qytetare dhe fshatare Berat”** përfaqësuar nga znj. Eneida Bibo me pozicion Drejtore Ekzekutive dhe znj. Arta Dyrmishi me pozicion Presidente.

OBJEKTI: Ankim ndaj Vendimit nr. 6 prot datë 20.02.2025 **“Për refuzimin e aplikimit për kërkesën për përfitim financimi nga buxheti i shtetit për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti”**.

BAZA LIGJORE: Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 74, datë 28.01.2025 “Për ngritjen e komisionit vlerësues për shqyrtimin edhe vlerësimin e aplikimeve për financim të organizatave jofitimprurëse të autorizuara dhe të komisionit të ankimit për shqyrtimin e ankesave të organizatave jofitimprurëse të autorizuara”.

- Njoftimin mbi thirrjen për aplikim të shpallur në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, më datë 09.01.2025, thirrje e cila mbeti e hapur për 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga momenti i publikimit të thirrjes.
- Ligjin nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

- Ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”.
- VKM-së Nr.110, datë 6.3.20219, “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”, ndryshuar me VKM nr. 227, datë 23.04.2023.
- Rregulloren e Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas”, miratuar me Urdhër nr.393, datë 23.11.2020, të Ministrit të Drejtësisë;
- Metodologjinë mbi procedurat e financimit të organizatave jofitimprurëse të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë, miratuar me Urdhrin nr. 4 datë 07.01.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.

Komisioni i Ankimit, pasi shqyrtoi pretendimet e ankuesit

VËREN SE:

Referuar dokumentacionit të përcjellë në aplikimin e Organizatës Jofitimprurëse “**Shoqata Mbrojtja e të Drejtave të gruas qytetare dhe fshatare Berat**” rezulton se Komisioni i Vlerësimit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve për financim të organizatave jofitimprurëse të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë, me Vendimin Nr. 131/5 prot datë 24.02.2025 **vendosi unanimisht refuzimin e aplikimit për financim.**


Pranë Komisionit të Ankimit në Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas me datë 03.03.2025, Nr. 4347/3 Prot., është administruar ankimi i **Shoqatës “Mbrojtja e të Drejtave të gruas qytetare dhe fshatare Berat”** përfaqësuar nga znj. Eneida Bibo me pozicion Drejtore Ekzekutive dhe znj. Arta Dyrmishi me pozicion Presidente.

Kundër Vendimit të Komisionit të Vlerësimit Nr. 131/5 prot datë 24.02.2025, në ankimin me shkrim përfaqësuesit e **Shoqatës “Mbrojtja e të Drejtave të gruas qytetare dhe fshatare Berat”** kanë parashtruar si më poshtë vijon:

- 1) Mungesa e numrit të shtresës targetuese gjë që nga ana e OJF-së nuk është parë me vëmendje pasi në aplikim janë përmendur si grupe targetuese (200 & 300 & 300) shtetas që do të identifikoheshin në ambjente të ndryshme;
- 2) Dokumentet mbështetëse ishin në zyrat e ndihmës ligjore falas (të përditësuar) deri në tre mujorin e fundit dhe OJF është keqkuptuar nga insitucionet ndërvartëse që nuk nevojiteshin për organizatën meqënëse ishin të disponueshme në DNJF.
- 3) Nuk është marrë në konsideratë lokaliteti, kushtet, grupet vulnerabël me të marginalizuara në këtë rreth, nuk është marrë në konsideratë që nga puna e bërë nga kjo Shoqatë, etj;

Në vijim të këtyre pretendimeve, ankuesi ka kërkuar “Mirëkuptim për të administruar të gjithë dokumentacionin e përcjellë në mbështetje të ankimit, të renditura si më poshtë vijon:

1. Ankesë;
2. Formulari TIP i aplikimit;
3. Aneksi “Deklaratë TIP mbi financimin e dyfishtë”;
4. Vendim nr. 218 datë 16.01.1998;
5. Certifikatë regjistrimi;
6. Statuti i Shoqatës;
7. Letër reference datë 14.05.1998 e Ministrisë së Rendit Publik;
8. Letër reference datë 14.05.1998 e Preferkturës Berat;
9. Vërtetim datë 25.02.2025 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
10. Vërtetim datë 24.02.2025 nga Zyra e Regjistrimit të OJF-ve pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
11. CV e organizatës;
12. Autorizim i Ministrit të Drejtësisë për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti;
13. Liçencë;
14. Shkresë “Miratim kërkesë për licensim” e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;
15. Liçencë e lëshuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës (2010)
16. Liçencë e lëshuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës (2012)
17. Urdhër nr. 299 datë 12.05.2022 “Për njohjen e statusit “Ndërmarrjet sociale” Shoqatës MDG-Berat;;
18. Memorandum mirëkuptimi, Tetor 2023;
19. Pasqyrat financiare viti 2021, 2022, 2023;
20. Vërtetim datë 25.02.2025 nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat për zj. Arta Dyrmishi, nuk ka proces penal;
21. Vërtetim datë 26.02.2025 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat për zj. Arta Dyrmishi, nuk rezulton të ketë procedim penal të regjistruar;
22. Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore për zj. Arta Dyrmishi datë 24.02.2025;
23. Vërtetim datë 26.02.2025 nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat për zj. Eneida Bibo, nuk ka proces penal;
24. Vërtetim datë 26.02.2025 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat për zj. Eneida Bibo, nuk rezulton të ketë procedim penal të regjistruar;
25. ID Eneida Bibo;
26. Vërtetim datë 25.02.2025 nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat për zj. Mimoza Qinami nuk ka proces penal;
27. Vërtetim datë 24.02.2025 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat për zj. Mimoza Qinami, nuk rezulton të ketë procedim penal të regjistruar;
28. Vërtetim datë 24.02.2025 nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat për pagim detyrimesh;



29. Listëpagesë e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shqndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi (08.01.2025)
30. Listëpagesë e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shqndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi (08.02.2025);
31. Listëpagesë e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shqndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi (05.12.2024)
32. Numri i llogarisë bankare;

Rrethanat faktike të çështjes,

Pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas është administruar kërkesa e organizatës jofitimprurëse **Shoqata “Mbrotja e të Drejtave të gruas qytetare dhe fshatare Berat”** protokolluar me Nr. 434 Prot., datë 06.02.2025. Organizata Jofitimprurëse ka aplikuar për financim nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti.

- Bazuar në Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 74, datë 28.01.2025 *“Për ngritjen e komisionit vlerësues për shqyrtimin edhe vlerësimin e aplikimeve për financim të organizatave jofitimprurëse të autorizuar dhe të komisionit të ankimit për shqyrtimin e ankesave të organizatave jofitimprurëse të autorizuar”*.
- Njoftimin mbi thirrjen për aplikim të shpallur në Buletinin e Njoftimeve zyrtare, më datë 09.01.2025, thirrje e cila mbeti e hapur për 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga momenti i publikimit të thirrjes
- Ligjin nr.111/2017 *“Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”*.
- Ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 *“Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”*.
- VKM-së Nr.110, datë 6.3.20219, *“Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”*, ndryshuar me VKM nr. 227, datë 23.04.2023.
- Rregulloren e Brendshme *“Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas”*, miratuar me Urdhër nr.393, datë 23.11.2020, të Ministrit të Drejtësisë;
- Metodologjinë mbi procedurat e financimit të organizatave jofitimprurëse të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë, miratuar me Urdhrin nr. 4 datë 07.01.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.

Organizata ka përcjellë dokumentacionin e poshtëshënuar:

1. Deklaratë e përfaqësuesit ligjor të organizatës jofitimprurëse të autorizuar që nuk përfiton burime të ngjashme/njëjta financimi për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore. *(Deklarata TIP sipas thirrjes) e datës 02.02.2025 (Dokument original);*
2. Formulari TIP i aplikimit, ku pjesë e të cilit janë:
 - a) Oferta financiare e projektit sipas thirrjes ku rezulton se oferta financiare e projektit dt. 06.02.2025 (origjinale) është në vlerën 938,208.00 lekë;
 - b) Referuar formularit TIP të aplikimit, nga ana e organizatës është planifikuar që juristi të ketë 25 vite eksperiencë pune, duke tejkaluar kriterin minimal të përcaktuar në thirrjen për financim;
 - c) Referuar formularit TIP të aplikimit, nga ana e organizatës është planifikuar që juristi të ketë pagën IV-3, në përputhje me kriteret e përcaktuara në thirrjen për financim;

- d) Ofrimi asistencës ligjore falas për 25 individë me probleme në çështjet civile, administrative apo penale. Jo në përputhje me targetin minimal të përcaktuar në thirrjen për financim 200 raste në vit, por jo më pak se 50 raste çdo 3 (tre) muaj)

Komisioni i Vlerësimit pas administrimit të dokumentacionit të dorëzuar përmes aplikimit të Shoqatës “Mbrotjtja e të Drejtave të gruas qytetare dhe fshatare Berat”, bazuar në Nenin 35 e vijues të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas”, të miratuar me Urdhrin e Ministrit Nr. 393, datë 23.11.2020, ka zhvilluar procedurat e mbledhjes së Komisionit dhe ka shqyrtuar dokumentacionin përkatës. Kjo referuar procesverbaleve të mbajtura nga Sekretariati Teknik pranë këtij Komisioni.

Në vendimmarrjen përfundimtare, Komisioni i Vlerësimit ka vendosur:

Refuzimin e aplikimit për financimin të Organizatës jofitimprurëse “Mbrotjtja e të drejtave të gruas qytetare dhe fshatare Berat”, në kushtet kur:

- Targeti i përcaktuar në formularin e aplikimit të përcjellë nga ana e organizatës është nën parashikimet e targetit minimal të vendosur në thirrjen për aplikim të shpallur nga DNJF;
- Nga ana e organizatës është përcjellë vetëm formulari TIP i aplikimit për projekt dhe deklarata që nuk ka dy burime të njëjta financimi, duke mos përcjellë asnjë prej dokumentacionit të kërkuar në thirrjen për financim botuar në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare nr.1/2025.

Referuar Metodologjisë mbi procedurat e financimit të organizatave jofitimprurëse të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë, miratuar me Urdhrin nr. 4 datë 07.01.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, thirrja është shpallur në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare më datë 13.01.2025, thirrje e cila ishte e hapur për 30 ditë kalendarike nga momenti i publikimit.

Ky njoftim ka qenë i publikuar në faqen zyrtare elektronike të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe me shkresën Nr. 47 Prot., datë 07.01.2025, është përcjellë pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, “Kërkese për publikim e thirrjes për financimin e OJF-ve të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore”.

Në këtë kuadër me qëllim trajtimin e aplikimeve të paraqitura në afatet e mësipërme, në zbatim të VKM Nr. 110, datë 06.03.2019 të ndryshuar dhe në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr. 74, datë 28.01.2025 “Për ngritjen e komisionit vlerësues për shqyrtimin edhe vlerësimin e aplikimeve për financim të organizatave jofitimprurëse të autorizuara dhe të komisionit të ankimit për shqyrtimin e ankesave të organizatave jofitimprurëse të autorizuara” u ngrit Komisioni i Vlerësimit dhe i Ankimit.

Pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas është administruar kërkesa e Shoqatës “Mbrotjtja e të Drejtave të gruas qytetare dhe fshatare Berat” protokolluar me Nr. 434 Prot., datë 06.02.2025. e cila rezulton e autorizuar nga Ministri i Drejtësisë me Urdhër nr. 503 datë 07.10.2024.

Në vijim të trajtimit të këtij aplikimi, me Vendimin Nr. 131/5 prot datë 24.02.2025 Komisioni i vlerësimit **vendosi unanimisht refuzimin e aplikimit për financim.**

Me Njoftimin Nr.131/5 Prot, datë 24.02.2025 “Mbi përfundimin e procedurës së aplikimit për përfitimin e financimeve nga buxheti i shtetit, të OJF-eve të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë”

“Për ofrimin e ndihmës juridike parësore”, organizata Jofitimprurese ka marrë dijeni në lidhje me vendimin dhe në vijim me shkresën e protokolluar pranë Drejtorisë me Nr. 434/3 Prot, datë 03.03.2025, organizata ka ushtruar të drejtën e ankimit.

Komisioni i Ankimit konstaton se ankesa e organizatës së depozituar me Nr. 434/3 Prot, datë 03.03.2025,, është bërë brenda afatit 5 (pesë) ditor të parashikuar në Pikën 16 të VKM Nr. 110, datë 06.03.2019, të ndryshuar.

Komisioni i Ankimit duke u bazuar në procedurat e mësipërme, mbi dokumentacionin e depozituar nga organizata, parashtrimet e paraqitura në ankim, dhe vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit, konstanton se:

Bazuar në Pikën 2, të VKM Nr. 110, datë 06.03.2019, *“Për përcaktimin e procedurave të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”,* të ndryshuar rezulton se procedurat e përfitimit të financimit të organizatave jofitimprurëse të autorizuara janë bërë duke u bazuar në parimet:

- a) konkurueshmërisë;
- b) trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të organizatave jofitimprurëse të autorizuara;
- c) transparencës të të gjithë fazave që lidhen me shqyrtimin, vendimmarrjen dhe përzgjedhjen e organizatave jofitimprurëse të autorizuara;
- ç) kriterëve të mirëpërcaktuar dhe publike;
- d) efektivitetit dhe ekonomizimit në shfrytëzimin e fondeve publike;
- dh) respektimin të plotë të parimeve të llogaridhënies dhe raportimit në përdorim të fondeve publike
- e) financimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore të kategoritëv e përfituesve që janë me prioritet për DNJF-në.
- ë) ruajtjes së pavarësisë së OjF-së së Autorizuar
- f) parandalimit të konfliktit të interesit, si dhe të çdo aktiviteti tjetër që rrezikon ofrimin me integritet të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

Në Pikën 6, shkronja “b”, iv), të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 110, datë 06.03.2019, të ndryshuar përcaktohet shprehimisht se: *“Për t’u kualifikuar për të përfituar financime, organizatat jofitimprurëse të autorizuara duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, përfshirë këtu edhe kërkesa të tjera specifike që mund të jenë të nevojshme për ofrimin e ndihmës juridike parësore, sipas thirrjes publike të veçantë”.*

Këto kërkesa specifike janë përcaktuar në Metodologjinë mbi procedurat e financimit të organizatave jofitimprurëse të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë, miratuar me Urdhrin nr. 4 datë 07.01.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.

Evidentohet se organizata në përputhje me Pikën 6 të VKM Nr. 110, datë 06.03.2019, të ndryshuar *“Për përcaktimin e procedurave të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”,* nuk ka depozituar dokumentacionin e kërkuar,

referuar të cilit, Komisioni i Vlerësimit në analizë përmbajtësore ka konkluduar në mosplotësimin e kriterëve.

Sa më sipër, rezulton se Shoqata MDG Berat nuk i ka përmbushur në mënyrë të rregullt kriteret ligjore të përcaktuara në nenin 15 të Ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”; VKM-së Nr.110, datë 6.3.20219, “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”, i ndryshuar si dhe Metodologjinë mbi procedurat e financimit të organizatave jofitimprurëse të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë bazuar në thirrjen për financim.

PËR KËTO ARSYE

Duke marrë në konsideratë faktin se bazuar në Pikën 8 të VKM-së Nr. 110, datë 06.03.2019, të ndryshuar Komisioni i Ankimit ka në tagrat e tij shqyrtimin e ankesave për shkelje të qëllimshme të procedurës së shqyrtimit të vendimeve për përzgjedhjen e Organizatave Jofitimprurëse të autorizuara që përfitojnë financim, si dhe të masës së financimit, bazuar në shpalljen nr. 47 datë 7.1.2025 të thirrjes për financimin e OJF-ve të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore për vitin 2025, përbën shkak automatik skualifikimi mungesa e dokumentacionit sipas kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta (*përveç dokumentacioneve që përbëjnë avantazh*) si dhe referuar metodologjisë dhe thirrjes për financim, aktiviteti i ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore është aktivitet i detyrueshëm për tu plotësuar në kuadër të përmbushjes së objektivit të përgjithshëm, mungesa e të cilit sjell skualifikimin.

Sa i përket pretendimit se; “Mungesa e numrit të shtresës targetuese nuk qëndron pasi Komisioni i Vlerësimit nuk ka parë me vëmendje, në kushtet kur në aplikim janë përmendur si grupe targetuese (200 & 300) shtetas që do të identifikoheshin në ambiente të ndryshme”, Komisioni i Ankimit konstatoi se keni referuar në prioritetin nr. 2 të Formularit TIP, 200 raste për muajin Prill, për muajin Korrik 200/300 raste, për muajin Gusht 300/300 raste. Lidhur me këtë rrethanë sqarojmë se në thirrje dhe konkretisht Aneksi nr.2, pjesa II, pika 3, është parashikuar që duhen përcaktuar minimalisht 200 raste në vit, por jo më pak se 50 raste çdo 3 muaj, ndërkohë që për muajin Janar, Shkurt dhe Mars, nuk është evidentuar asnjë rast, duke mos u plotësuar kriteri i mësipërm.

Nëse i referohemi Pjesës III - Kalendar i Realizimit të Aktiviteteve, të formularit TIP të aplikimit të përcjellë nga organizata “MDG BERAT” nga ana e organizatës nuk është përfshirë si aktivitet në asnjë nga muajt në kalendar, ofrimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore, por janë përfshirë aktivitete informuese dhe ndërgjegjësuere, të cilat nuk kostohen dhe nuk janë pjesë e aktiviteteve kryesore të parashikuara në thirrjen për financim.

Nëse i referohemi Pjesës IV - “Përfituesit e drejtëpërdrejtë nga projekti”, të formularit TIP të aplikimit të përcjellë nga organizata “MDG BERAT” rezulton se nga ana e organizatës përfitues të drejtëpërdrejtë të projektit konsiderohen juristë të shoqatës MDG BERAT dhe grupet targetues të të gjithë familjeve në nevojë dhe jo vetëm për të gjithë qarkun Berat.

Gjithashtu sa i përket kërkeses se OJF-së për të administruar të gjithë dokumentacionin e përcjellë në mbështetje të ankimit, theksojmë se në këtë fazë të procesit nuk është në tagrin e Komisionit

të Ankimit administrimi dhe vlerësimi i dokumenteve për aplikim , të cilat kanë afatin e tyre ligjor të vlefshmërisë. E drejta e ankimit ndaj vendimit të Komisionit Vlerësues, nuk rivendos në afat detyrimin që kanë OJF-të për të dorëzuar dokumentacionin e detyrueshëm në momentin procedural të aplikimit.

Sa më sipër, rezulton se Shoqata MDG Berat nuk i ka përmbushur në mënyrë të rregullt kriteret ligjore të përcaktuara në nenin 15 të Ligjit nr. 111/2017, *“Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”*; VKM-së Nr.110, datë 6.3.20219, *“Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuarra për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”*, i ndryshuar si dhe Metodologjinë mbi procedurat e financimit të organizatave jofitimprurëse të autorizuarra nga Ministri i Drejtësisë bazuar në thirrjen për financim.

Në këto rrethana, bazuar në Pikën 17 dhe 18, VKM Nr. 110, *“Për përcaktimin e procedurave të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuarra për ofrimin e ndihmës juridike parësore nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”*, Komisioni i Ankimit unanimisht:

VENDOSI:

1. Mospranimin e ankimit të paraqitur nga Organizata Jofitimprurëse **“Shoqata Mbrojtja e të Drejtave të gruas qytetare dhe fshatare (MDG) Berat”**
2. Kopje e këtij vendimi t’i njoftohet Organizatës jo më vonë se dy ditë nga marrja e vendimit.
3. Ngarkohet Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas për njoftimin dhe publikimin e këtij vendimi sipas parashikimeve ligjore.
4. Kundër këtij vendimi ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative kompetente, sipas legjislacionit në fuqi.

KRYETAR
Erjon Ndreca



ANËTAR

Klejda Poçi



ANËTAR

Arsilda Mamica



U shpall në Tiranë,
me datë 17.03.2025

Ky vendim hartohet në 5 (pesë) kopje.